



**NJË NATË E REALIZUAR
BESIMI, NË HARTËN E
“DITËVE TË NUMËRUARA”..!**



**TERAVIA 20 REKATË,
ME KONSENSUSIN
E TËRË SAHABËVE!**



**MOS TA KTHEJMË MUAJIN
E AGJËRIMIT NË MUAJ
TË USHQIMIT..!**

UDHA ISLAME

Botim i Myftinisë Shkodër
E përmuajshme
Informative - Fetare
Kulturore - Edukative

Viti 24 - Nr. 2 (276), Shkurt, 2026

www.myftinia-shkoder.org



MYFTINIASHKODER1990



Ramazani, MUAJI I NJERIUT NË KËRKIM TË VETVETES!

MYFTIU I SHKODRËS MORI PJESË
NË AKTIVITETIN E MYFTINISË ELBASAN
NË PRAG TË RAMAZANIT

MYFTIU PRITI KRYETARIN E BASHKISË
SHKODËR NË PRAG TË MUAJIT
RAMAZAN 1447/2026

TERAVIA E PARË NË XHAMITË
E SHKODRËS, SHËNON FILLIMIN
E RAMAZANIT 1447/2026

BEREQETI I MUAJIT TË RAMAZANIT
GËZON 250 FAMILJE

“TË NDRIÇOHEMI, PO NA VJEN MUAJI
I KUR'ANIT!”, MESAZHE DHE KËSHILLA
NGA MYFTIU I SHKODRËS

MYFTINIA SHKODËR PRANË FAMILJEVE
NË NEVOJË NË PRAG TË MUAJIT TË
BEGATË TË RAMAZANIT 1447/2026



Imam Muhamed Sytari
Myfti i Zonës Shkodër

MUAJI I NJERIUT NË KËRKIM TË VETVETES!

njerëzit të përkushtohen siç duhet në ditët e Ramazanit do të kuptonin se ato nuk janë thjesht ditë të rëndomta që pasojnë njëra-tjetrën, por një shkollë e mirëfilltë 30 ditore që e merr për dore njeriun për t'u lartësuar drejt vlerave më të larta, të besimit, të altruizmit, të dashurisë e të mirëkuptimit, të paqes e të harmonisë në mesin e njerëzve.

Të dashur dhe të shtrenjtë,

Të dashur dhe të shtrenjtë, të gjithë ju që ndjeheni të përfshirë në thirrjen hyjnore: “O ju të cilët keni besuar, ju është bërë obligim agjërimi, ashtu sikurse ishte edhe për popujt e më përparshëm, që ju të mbërrini në shkallët më të larta të përkushtimit!”

Të dashur dhe të shtrenjtë, motra dhe vëllezër,

Elhamdulillah, koha po kalon dhe në mesin tonë afrohet shfaqja e Hënës së re të Ramazanit. Të gjithë ne presim atë moment fatlum, ku nëpërmjet minareve të qytetit tonë me akshamin e kësaj dite thirret me të madhe “Allahu Ekber” drejt namazit, por edhe drejt lajmit të gëzueshëm se hëna e re e Ramazanit tashmë është shfaqur në mesin tonë, dhe krejt bota bëhet Ramazan, dhe krejt atmosfera jonë mbushet me dritën dhe bekimet e këtij muaji të shumëpritur; për të cilin lexojmë se po ta dinin njerëzit vlerën e Ramazanit do të dëshironin që krejt jeta e tyre të ishte Ramazan, e për të cilin mësojmë se kur

të pandashme me Kur'anin Famëlartë, i cili nisi të shpallej në këtë muaj të begatë të Ramazanit.

Që të thuash një prej etiketave më të spikatura të këtij muaji të begatë është pikërisht momenti fatlum për Pejgamberin tonë (a.s), për arabët e gadishullit të asaj kohe dhe për mbarë njerëzimin, fillimi i shpalljes së Kur'anit, i cili është udhëzim drejt më të mirës absolute në çdo kohë e në çdo vend prandaj le të kthehemi nga Kur'ani, le të kthehemi nga drita e tij, për të cilin lexojmë e lexojmë nga mendjet më të ndritura të historisë së njerëzimit, se ky libër është më të vërtetë pishtari i udhëzimit dhe rregullatori i jetës mbi faqen e dheut.

Le të na shërbejë ky muaj i begatë i Ramazanit për t'u kthyer me vëmendjen tonë drejt skamnorëve, të sëmurëve, njerëzve në nevojë, për të zgjatur dorën e bujarisë, mirësisë me sa të kemi mundësi. Le të na shërbejë ky muaj i Madhërueshëm i Ramazanit për të rregulluar marrëdhëniet tona me adhurimet ditore, me namazin, me dhënien e zekatit, me përmirësimin e gjithsecilit prej adhurimeve ditore.

Le të na shërbejë ky muaj i Begatë i Ramazanit për t'u rikthyer me sinqeritet dhe përkushtim drejt dyerve që kurrë nuk mbyllen të Zotit tonë, i cili na thërret për mëshirë, për falje, për bujari, për bamirësi, për të gjetë njeriu vetveten.

Me zemër të mirë Ramazanin!

NJË NATË E REALIZUAR BESIMI, NË HARTËN E “DITËVE TË NUMËRUARA”..!

Të dielën e 22 shkurtit 2026, xhamia e Bardhjavë dhe Qendra Kulturore e saj ishin zbuluar me dritat e Muajit Ramazan.

Dita e katërt e këtij Ramazani, ishte nisur drejt perëndimit, teksa ata, që dikur ishin fëmijët e mejtepit, sot të rinjtë aktivë të xhamisë, gumëzhnin në përgatitjet e fundit për iftarin vëllazëror të kësaj dite.

Bashkë me imamin e xhamisë, të nderuarin, H. Ilir Dizdari dhe grupin mbikqyrës, po bënin çdo përpjekje që çdo detaj të këndonte. Dhe, çdo detaj i këtij organizimi këndonte...

Shumë prej të rinjve të kësaj sofere bujare, dikur djemtë e mejtepit e “bylbylat e xhamisë”, siç thonin plot gëzim, më të moshuarit e kohës; sot, kanë kryer universitetet, janë diplomuar e vazhdojnë specializimet në lëmi të ndryshme të diturisë. Shumë të tjerë në ato gjurmë të bekuara, vazhdojnë rrugën e lartësisë, për të kapur fillin e dijes së pakufizuar, në hapat e vëllezërve të tyre të mirë.

Më ngajnjë me të rinjtë e Kehfit, që përkushtimin e tyre e jetojnë në hapat e matur që hedhin në jetë, për t'u bërë secili një burim dobie dhe rrezatim i edukatës dhe formimit të mësuar në xhaminë, që i rriti dhe i bëri burra të mbarë!

Sonte, u bashkuam në sofrën e iftarit, në sallën e Qendrës Kulturore, që e ka gjallëruar edhe më shumë këtë xhami, duke e bërë stacionin më të dashur për të gjithë banorët përreth.

Aty falen, aty takohen, aty bashkohen, aty argëtohen, aty kanë një pikë takimi e përherë, një derë që kurrë nuk mbyllet për këdo që troket, përtej çdo gjëje!



Fytyra të qeshura, urime e bekime, lutje e përsëritjet plot prekje vëllazërie, janë detajet që spikasin në një vështrim të shpejtë.

Shpejt e shpejt, koha e iftarit afron dhe të gjithë, me një lutje të heshtur e një tjetër në sfond, çelin ditën e re të një adhurimi të pashoq, që sa shumë na paska munguar...

Koha e iftarit rrjedh, si rrjedhat e Kirit, bri nesh dhe, për pak, jemi rreshtuar në safet e namazit të akshamit.

Ka ngelur akoma për të mbërritur koha e jaxisë dhe një mexhlis për zemër, na bashkon në hallkën e një bashkëbisedimi të përzemërt, që ka shijen e ndejave të paharruara në memorien e secilit.

Dalëngadalë, xhamia nis të mbushet. Më të moshuarit me nipa e mbesa, baballarët me djem e vajza, të rinjtë me vëllezër e motra, por edhe ndonjë kalimtar, afrohet dhe me mbushjen e sallës së faljes afron edhe ora e ezanit, që na lajmëron për jacinë e kësaj nate dhe 20 rekatet e teravisë së shtrenjtë.

Ligjërata e kësaj nate, fokusohet

tek një bashkëbisedim që një burrë i shpërqendruar ka me Plakun fytyrëbukur e mjekërbardhë që i troket në dyert e një ëndrrë të çuditshme. Është Ramazani, që si simbolikë e rimëkëmbjes, vjen ta zgjojë nga gafleti i rutinave duke e ftuar që këto “ditë të numëruara” të tij, mos të kalojnë si çdo ditë e natë e përditshmërisë së hutuar...

Kënaqësinë e kësaj ligjërate e shton prania e sa e sa fëmijëve dhe të rinjve, që me gumëzhitjen e tyre, i japin jetë xhamisë, e në këmbim, marrin tharmin e etikës, moralit e qytetarisë së vlerave të besimit, që njeriun e mban përherë në ekuilibrin e duhur.

Një mbrëmje që nisi me iftarin e një dite plot përkushtim dhe u plotësua me detajet e një nate të ndriçuar me dritën e zemrës së secilit, që me praninë e tij, la një gjurmë të ndjerë në hartën plot llambushka të ndezura të kësaj dite Ramazani...

Allahu e pranoftë!

Imam Muhamed B. Sytari

Xhamia Bardhaj, më 22 shkurt 2026



NGUSHËLLIM!

"Të Allahut jemi dhe tek Ai do të kthehemi!"

Me dorëzim të plotë para kaderit të Allahut, Myftinia Shkodër lajmëron opinionin e gjerë publik se, më 24 shkurt 2026, në kryeqytetin e Kuvajtit, ndërroi jetë dijetari i shquar islam dhe muxhteidi i kohës:

Hirësia e Tij, Prof. Dr. Muhamed Hasan Hito.

Me këtë rast, Myftinia Shkodër dhe Myftiu i saj, Imam Muhamed B. Sytari, shprehin ngushëllimet më të thella për mbarë ymetin islam me rastin e largimit nga bota e përkohshme e dijetarit dhe kolosit të shquar islam, Prof. Dr. Muhamed Hasan Hito.

JETËSHKRIM:

Muhamed Hasan Hito (1362–1447 hixhri / 1943–2026) dijetar i shquar sirian, ez'herist, profesor universitar dhe erudit i pashembullt i kohës tonë.

Ai konsiderohet ndër dijetarët më të mëdhenj të Usul El-Fikhut në kohën e tij, ndër juristët më të shquar të medhhebit shafi'i, si dhe themelues i Universitetit Imam Shafi'i në Indonezi.

Ai kishte interes dhe kontribut në fusha të ndryshme të shkencave islame sheriatike, si në akide, shkencën e hadithit dhe shkencat e gjuhës arabe. Ishte gjithashtu letrar dhe poet.

Studioi në Universitetin El-Ez'her dhe mori prej tij gradën e doktoraturës.

U bë i njohur për inkurajimin e tij në përkushtimin ndaj mësimin dhe



përvetësimit të thellë të shkencave sheriatike, si dhe për kritikimin e guximit në dhënien e fetvave pa dije të mjaftueshme. Për këtë çështje ka shkruar një libër të titulluar: "El-Mutefehikun" ("Ata që shtiren si dijetarë").

Gjatë jetës së tij, Prof. Dr. Muhamed Hasan Hito ka shkruar shumë vepra me vlerë shkencore në disa lëmi, ku ishte specialist.

Vlen të theksohet kryevepra e tij e pa përfunduar, "Enciklopedia e fikhut shafi dhe e krahasuar", e cila ishte projektuar për të dalë në rreth 160 vëllime, por që deri më sot, janë botuar vetëm 60 vëllime të mëdha prej saj.

Kontributi i tij i shquar:

- Themelues dhe dekani i Fakultetit të Universitetit Imam Shafi'i në Indonezi.

- Themelues dhe drejtor i Qendrës Ndërkombëtare për Shkencat Islame në Gjermani.

**Pejgamberi (a.s) ka thënë:**

“*Allahu i Lartësuar
jua ka bërë obligim
agjërimin e Ramazanit,
ndërsa unë jua kam bërë
sunet (traditë) namazin
e tij (teravinë).
Kështu që, kush
e agjëron Ramazanin
dhe falë teravinë,
me besim, me bindje
dhe vendosmëri,
ai njeri do të dalë
nga Ramazani i pastër
nga gabimet,
si ditën që e ka lindur
nëna e tij.*”

(Transmeton Nesaiu)



Prof. Dr. Hasan Hito
(1943 – 2026)

Konsensusi (ixhmai), të argumentuarit me konsensus.

Konsensusi është kështjella e pamposhtur e kësaj feje! Sikur të mos ishte konsensusi, njerëzit do të kishin dyshuar në shumë mesele të sheriatit, për të cilat ymeti ka rënë dakord rreth tyre.

Konsensusi ndahet në tre pjesë:

- Konsensus thëniesh (në të folur),
- Konsensus veprimi dhe,
- konsensus i heshtur.

Konsensusi në të folur, duke ndjekur një mesele dhe duke folur rreth saj. Ky është konsensus thëniesh (në të folur).

Konsensusi në të vepruar, dikush vepron prej imamëve diçka dhe thotë: Ky është vendimi për të, njerëzit janë dakord me të, ose veprojnë veprën e tij. Ky është konsensus veprimi.

Ndërsa, *konsensusi i heshtur*, ky quhet: kur ndonjëri prej dakorduesve të thotë një thënie dhe i arrin të gjithë muxhteidinëve (interpretuesve) dhe nuk e kundërshtojnë për të; ky quhet: Konsensus i heshtur.

Dhe, prej shembujve më madhështor të këtij konsensusi është dakordësimi i ymetit të Muhamedit (a.s) për namazin e teravisë, se ai është **20 rekatë!**

Omer ibnul-Hatabi i bashkoi burrat pas një lexuesi (imami) dhe i bashkoi gratë pas një lexuesi (imami) dhe u

**TERAVIA 20 REKATË,
ME KONSENSUSIN E TËRË SAHABËVE!**

falën 20 rekatë! Në mesin e atyre, ishin sahabët e mëdhenj. Në mesin e tyre ishin katër Abdullahët; 10 të përgëzuarit me xhenet dhe krejt sahabët e mëdhenj të Pejgamberit (a.s). Ata ishin në konsensus... konsensus të folurit, se: *namazi i teravisë është 20 rekatë!*

Edhe konsensus veprimi! E kanë vepruar dhe nuk i ka kundërshtuar askush! Që nga koha e sahabëve, e deri në ditët tona është konsensus i heshtur, të gjithë e kanë pranuar Omer ibnul-Hatabin, se **namazi i teravisë është 20 rekatë**, dhe nuk pasur asnjë, që e ka kundërshtuar Omer ibnul-Hatabin, përveçse në këtë kohë!

Kështu, El-Albani ka thënë: "Kush shton në namazin e teravisë më shumë se 8 rekatë, është sikur ai që shton në namazin e drekës!" Dmth: Qafira!! Dmth, kushdo që ka falë 20 rekatë, prej sahabëve, tabiinëve, imamëve muxhtehidë, etj., është qafir, sepse ai ka shtuar në namazin e teravisë, sikur të kishte shtuar në namazin e drekës rekatë më tepër?!

Nuk po shpif për të, sepse libri i tij ekziston, secili prej jush mundet ta lexojë.

Njerëzit tani janë kapur pas tij (El-Albanit), sepse pkjo i përshtatet egos së pjesës më të madhe të tyre, pra të mos i falin 20 rekatë, por vetëm 8 rekatë!

Nuk ka asnjë problem; fal 2 rekatë, s'ka problem; fal 4, Allahu ta shpërbleftë me të mira; fal 20, Allahu ta shpërbleftë me të mira. Por, mos thuaj: "Kjo është bidat!" Mos thuaj: "Kjo nuk ka qenë e legjitimuar!!" Sikur ti po i imponon tërë ymetit të Muhamedit (a.s) kufrin!

Nëse dëshiron të mos e falësh aspak teravinë, nuk ka problem aspak; dikush ka një punë, është i zënë, është i sëmurë, nuk i është krijuar mundësia të falet, dhe nuk falet.

Kështu pra, shembulli më i madh i

konsensusit (ixhmasë) në atë çfarë ka rënë në konsensus ymeti i Muhamedit (a.s), në të folur, në të vepruar dhe në të miratuar, është pikërisht falja e namazit të teravisë me 20 rekatë.

Kështu falej ky namaz (pra, 20 rekatë) në Dy Xhamitë e Shenjta, në Mekë dhe në Medine tërë ato vite, dhe kështu falej në të gjitha xhamitë e botës islame.

Kur ishim studentë në Egjipt, nuk kujtoj, përveç disa xhamive të pakta që thonin se teravia falej 8 rekatë, dhe e lusim Allahun të na ruajë, ndërsa xhamitë e tjera të gjitha e falnin teravinë 20 rekatë.

I gjithë ymeti islam e falnin teravinë 20 rekatë. Ky bidat, që është përhapur sot (falja e teravisë me 8 rekatë), bie ndesh me ixhmanë (konsensusin) e ymetit të Hz. Muhamedit (a.s).

Nuk njoh asnjë prej dijetarëve të mi (ju kam thënë se unë jam një njeri me kulturë egjiptiane në dituri e në njohuri.., të gjithë dijetarët e mi janë egjiptianë. Unë nuk kam mësuar jashtë Egjiptit, por kam mësuar përgjatë jetës time 10 vite dhe kam vazhduar në Egjipt), dijetarët e mi, pa asnjë përjashtim, nuk njoh asnjërin prej tyre dhe asnjë prej dijetarëve të tyre, e as prej nxënësve të tyre, që të ketë thënë, se namazi i teravisë është 8 rekatë.

Edhe Ibn Tejmije, tek i cili mbështeten, ka thënë: "Namazi i teravisë është 20 rekatë, në çdo kohë dhe në çdo epokë!"

Por, "nuk verbohën sytë, verbohën zemrat, të cilat janë në kraharorë!" - (Kur'ani, El-Haxh: 46)

Elhamdulillah, që ne i kemi arritur dijetarët tanë në rrugën e vërtetë dhe, nuk kam arritur asnjërin prej tyre, që të ketë devijuar nga sheriatit i Allahut (a.xh) apo ta ketë ndryshuar atë!

Përktheu nga arabishtja dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja





Arben Halluni, teolog

Dihet se shumica e besimeve të përbashkëta të popujve të mëdhenj ishin të lidhura me ekzistencën e vendeve të fuqishme, kufijtë e të cilave tejkalonin përkatësitë fisnore dhe kombëtare. Këto vende quhen në kohën tonë “perandori”.

Ndër vendet që patën ndikimin më të madh në këtë drejtim përmenden Egjipti, Babilonia, India, Kina dhe Greqia. Japonia iu shtua më vonë kësaj liste, ndonëse për një periudhë të gjatë mbeti e izoluar. Me kalimin e kohës, ky izolim u zbut dhe ndikimi i saj arriti deri në fillimet e epokës moderne.

Sa i përket Egjiptit, ai përjetoi në fazat e hershme të historisë së tij një shumëllojshmëri besimesh, si para bashkimit të mbretërisë ashtu edhe pas tij. Adhurimi i simboleve ishte i përhapur. Shumë studiuues të historisë së feve mendojnë se shenjtërimi i shqiponjës, skifterit, demit, dashit, krokodilit dhe kafshëve të tjera ishte mbetje e totemizmit të lashtë. Me kalimin e kohës, këto forma humbën domethënien e tyre të parë simbolike dhe u shndërruan në rituale të institucionalizuara adhurimi.

Në Egjipt u përhap edhe besimi në shpirtin dhe jetën pas vdekjes. Egjiptianët e lashtë ishin ndër popujt më të hershëm që besuan në ringjallje dhe shpërblim pas vdekjes. Ata e simbolizonin shpirtin (Ka) herë si zog, herë si flutur, e herë si figurë njerëzore me kokë kafshe. Ata besonin se shpirti mund të merrte formë të ndryshme, por nuk pranonin idenë e rimishërimit në kuptimin e plotë filozofik të tij.

ALLAHU NË QYTETËRIMET E LASHTA EGJIPTI

Nga shenjat më të qarta të kësaj doktrine ishte kujdesi i jashtëzakonshëm për mumifikimin e trupave dhe ndërtimin e varreve madhështore. Këto praktika dëshmojnë bindjen e fortë në vazhdimësinë e jetës pas vdekjes. Më vonë, besimi diellor mori përmasa të gjera dhe u lidh me hyjninë Osiris, e më pas me forma të tjera të adhurimit.

MITI I OSIRISIT

Historia e Osirisit përfaqëson një rrëfim mitologjik që pasqyron konfliktet e hershme brenda familjeve mbretërore. Sipas mitit, Osirisi u vra nga vëllai i tij Seti, i cili e copëtoi trupin e tij. Bashkëshortja e tij, Izida, i mblodhi pjesët dhe me anë të magjisë i riktheu jetën, duke lindur më pas djalin e tij Horusin. Horusi, pasi u rrit, u përball me Setin për të rimarrë fronin e të atit.

Ky mit u bë simbol i luftës ndërmjet së mirës dhe së keqes, si dhe i ciklit të vdekjes dhe ringjalljes. Me kalimin e kohës, Osirisi u konsiderua sundimtar i botës së të vdekurve, ndërsa Horusi simbol i mbretërimit tokësor.

ZHVILLIMI I BESIMIT DIELLOR

Adhurimi i diellit zuri një vend qendror në religjionin egjiptian. Dielli adhurohej me emra të ndryshëm si Ra, Amon dhe më vonë Aton. Fillimisht, këto ishin forma të ndryshme lokale, por me kalimin e kohës u përpoqën të unifikoheshin.

Në periudhën e Mbretërisë së Re, klerikët e Amonit fituan pushtet të madh politik dhe ekonomik. Kjo krijoi tension midis autoritetit mbretëror dhe elitës fetare.

REVOLUCIONI I AKHENATONIT

Në shekullin XIV para erës sonë, faraoni Amenhotepi IV, i njohur më pas si Akhenaton, ndërmori një reformë të thellë fetare. Ai promovoi adhurimin e Atonit ‘simbolit të diskut diellor’ si hyjni të vetme universale.

Kjo lëvizje përbënte një përpjekje të qartë drejt monoteizmit, duke kufizuar ndikimin e klerikëve të Amonit.

Atoni nuk përfaqësohej në formë

statuje antropomorfe, por si disk diellor me rreze që përfundonin në duar, simbol i jetës dhe mëshirës hyjnore. Kjo shënon një fazë të avancuar konceptuale, ku Zoti Fuqplotë shihet si burim universal i jetës, përtej formave materiale.

Megjithatë, pas vdekjes së Akhenatonit, kjo reformë u rrëzua dhe Egjipti u kthye në sistemin tradicional politeist.

VLERËSIM NGA KËNDVËSHTRIMI ISLAM

Studimi i këtyre zhvillimeve historike tregon se njerëzimi, në kërkim të së Vërtetës Absolute, kaloi nëpër faza simbolizmi, politeizmi dhe përpjekjes drejt njësimi të hyjnisë.

Islami e konsideron teuhidin (njësimin e Allahut) si besimin origjinal të njerëzimit, ndërsa devijimet janë rezultat i shtresëzimeve historike, mitologjike dhe politike.

Përpjekja e Akhenatonit për unifikimin e adhurimit, ndonëse e paplotë dhe e lidhur me konceptin e diellit si simbol, dëshmon se ideja e Një Zoti të vetëm nuk ishte e panjohur për mendimin njerëzor para shpalljeve përfundimtare hyjnore.

PËRFUNDIM TEOLOGJIK

Studimi i Egjiptit të lashtë dëshmon se:

- Ideja e jetës pas vdekjes ishte e rrënjësuar thellë në vetëdijen njerëzore.

- Përpjekjet për njësimin e adhurimit kanë ekzistuar, por kanë mbetur të papërfunduara.

- Devijimi ndodhi sa herë që krijesa u ngrit në nivelin e Krijuesit.

Islami e sheh këtë histori si dëshmi të fjalës hyjnore:

“Drejtije fytyrën tënde drejt fesë së drejtë, natyrshmëria e Allahut në të cilën Ai i krijoi njerëzit. Nuk ka ndryshim në krijimin e Allahut. Kjo është feja e drejtë, por shumica e njerëzve nuk e dinë.” - (Kur’ani, Er-Rum: 30)

Pra, teuhidi nuk është risi historike, por rikthim në natyrshmërinë (fitrah) me të cilën është krijuar njeriu.

KARTOLINA..!



Të hënë e 23 shkurtit 2026, më kishin ftuar për një iftar, më të veçantin e krejt Muajit... Iftari me jetimët, që organizonte Fondacioni “Mirësia”, ishte një ftesë, që nuk mund ta refuzoja, mbi të gjitha për nevojën time për të zbutur ashpërsinë e zemrës në këto ditë të para të Hanës së Bekuar... Një burrë iu ankua të Dërguarit të Allahut për ashpërsinë e zemrës së tij. E udhëzoi: “Fërkoje kokën e jetimit dhe ushqej skamnarin”²[2]...

E falënderova pa masë vëllain tim të zellshëm për veprat e mira në komunitet, z. Korab Kaja, si dhe imamin punëtor e të pandalshëm në tërheqjen e projekteve me dobi, z. Shkëlqim Sykaj, për organizimin dhe teksa, qëndroja bri tyre, vëreja me vëmendje fytyrat e qeshura të fëmijëve në qendër të sallës, teksa hareshëm, përjetonin momente të gëzuara të rrethuar nga ngrohtësia e të gjithëve...

Gjithandej tullumbace, që fluturonin si balona shprese, të bekuara nga duart e fëmijëve të ftuar, që në atmosferën e kësaj Nate të shënuar, po përjetonin një dritë më shumë në qëniet e tyre të brishta.., dritë Ramazani, që na fal të gjithëve, i madh e i vogël, mëshirë e butësi hyjnore, për të cilat kemi përherë nevojë, si jetimë zamani...

U ngrita të flas. Kisha shumë për të thënë e, gati-gati nuk dija nga t’ia nis. Nuk doja ta ndal zhurmën e zërave të tyre, as lojën e tullumbaceve, as vrapimin e tyre na hapësirat e sallës së madhe, ku ishim mbledhur...

Doja të thoja më shumë seç mund të përkufizohet në rreshta e, aq më pak seç mund të ndjehet realisht në atë pozitë, por... me lejen e mikut tim të mirë, që kishte ardhur nga Tirana për këtë darkë iftari, vendosa të ndaj me fëmijët, një pjesë të dhuratave, që Vakfi Turk i Jetimit, kishte përgatitur në bashkëpunim me Fondacionin “Mirësia”.

O Zot, çfarë emocioni e kënaqësie të vështrosh në fytyrat e tyre, si pasqyra të ndërgjegjes, ku mund të shohësh veten e të vëresh shumë të pathëna, që je në kohë të korrigjosh...

O Zot, çfarë emocioni të fërkosh kokat e tyre, teksa zgjat dorën me një dhuratë simbolike, të mbushur me copëza zemre, që rrahin akoma dashuri e përkujdesje për jetimin e begatuar me nofkën e Pejgamberit alejhis-selam...

Kartolina...

Brenda çdo pakoje, kishte edhe një kartolinë, që ma afruan ta lexoj. Kishte një dedikim, të shoqëruar e një lutje, ku shkruhej:

“Fëmijë i dashur,

Ti je shumë i çmuar për ne.

Sot të kemi dërguar një dhuratë, me shpresën që kur ta marrësh në dorë, të të bëjë të lumtur.

Sepse kur ti je i lumtur, edhe ne jemi të lumtur. Kur fytyra jote buzëqesh, buzëqesh edhe fytyra jonë.

Mbaj edhe për ne një vend në zemrën tënde dhe na përfshi edhe në lutjet e tua!

Të duam shumë dhe do të vazhdojmë të të duam gjithmonë...

YETËM VAKFI”

Një kartolinë, që përmbledh shumëçka në pak gjë, që secili prej nesh mund të arrijmë ta realizojmë, duke gjurmuar për një jetim, duke u kujdesur për edukimin e tij, për nevojat ditore, për të mos i munguar asgjë, përtej faktit se, edhe krejt botën po t’ia japim, nuk e kompensojmë as edhe një vështrim mëshirues të të Shtrenjtë Babë, as edhe një fjalë plot bekim nga zemra e tij, as edhe një buzëqeshje miradie nga fytyra e tij, që tashmë ka perënduar, si dielli i kësaj nate, që na bëri të gjithëve bashkë, në një përjetim të mrekullueshëm, në kornizat e një kartoline...

Imam Muhamed B. Sytari
Shkodër, më 24 shkurt 2026

O rret e Ramazanit janë të shpejta. Rrjedhin më shpejt se rrjedhat e lumenjve. Akrepat e orës lëvizin ndryshe nga çdo muaj e ditë. Ndoshta se, krejt gjërat e çmuara në jetë lëvizin me shpejtësi. Shëndeti, rinia, mirëqenia, rehatia, koha e lirë, prania e të dashurve, vetë jeta... “Po për atë i cili, kur kaloi pranë një qyteti të rrënuar përtokë, tha: “Si mund ta kthejë në jetë Allahu këtë qytet tani që ai është i vdekur?!” Dhe Allahu e vdiq atë për njëqind vjet e pastaj e ringjalli dhe e pyeti: “Sa kohë ke ndenjur këtu?” – Ai u përgjigj: “Një ditë ose gjysmë dite”. – “Jo” – i tha Allahu, “por ke ndenjur njëqind vjet. Shiko ushqimin dhe pijen tënde që nuk janë prishur! Shikoje gomarin tënd (si do ta ringjallim) që të të bëjmë ty dëshmi mrekullie për njerëzit; vështroji eshtrat se si i bashkojmë e pastaj i veshim me mish!” Kur atij iu bë e qartë, ai tha: “Tashmë e di se Allahu është i Fuqishëm për çdo gjë!”¹

Një ditë ose gjysmë dite... Në fakt, të gjithë, në një mënyrë a një tjetër e kemi një ditë ose një gjysmë dite, që tashmë ka shkuar dhe kurrë nuk kthehet më, edhe pse do donim që të ndodhte e kundërta, por...

Më merr malli për zanin e Nanës e për imazhin që fal siguri të Gjyshit; për bishtagypin e lyer në hoken e bojës në fletën e orës së bukurshkrimi; për netët pa rrymë elektrike, por të zbukurua me kandilat e dorës, kur përjetonim netët e Ramazanit pa dilemën e numrit të rekateve të teravisë dhe, për zërin e imami, që thaujse çdo natë përsëriste dhjetë suret e fundit, aq sa në fund të këtij Muaji Mubarek, ishim bërë të gjithë hafizë të tyre; për praninë e Babës në shtëpi dhe zërin e tij këshillues, në kohën dhe vendin e duhur, si një bekim i papritur dhe një ndihmë e pakërkuar, por shumë e munguar; për një palë sy që të ndjekin në heshtje duke u lutur për ty, pa hile, pa zugzage, pa smirë; për një Mësues të urtë që flet e ligjëron esencën e librave dhe largpamësinë e autorëve të shkuar, si receta jete, që të nevojiten në çdo hap; për butësinë dhe përkujdesjen e Nanës, që të bekon pa fjalë e të uron me vështrimet e zemrës, aq sa mjafton për të hapur shtigjet e jetës, që asgjë dhe askush nuk mund t’i hapë, veç duasë së Saj...

1. Kur’ani, El-Bekare: 259.

2. Transmetuar nga Imam Ahmed, nga sahabiu Ebu Hurejra.



Sheikh Muhamed El-Gazali
(1917 - 1996)

MOS TA KTHEJMË MUAJIN E AGJËRIMIT NË MUAJ TË USHQIMIT..!

Është detyrë e myslimanëve që të ndryshojnë traditat e tyre që bazohen mbi shpërdorimin dhe duhet që cilësia e adhurimit t'i kthehet muajit të adhurimit, si dhe të mbizotërojnë kuptimet e xhihadit (sakrificës) dhe aftësisë për rezistencë përballë dëshirave dhe epsheve.

Pjesa më e madhe e familjeve e presin muajin e Ramazanit me shqetësim, sepse çmimet janë rritur shumë dhe traditat e myslimanëve janë që muajin e agjërimit e bëjnë muaj të ushqimit, duke i rritur shpenzimet në këtë muaj, më shumë se çfarëdo muaji tjetër.

Është detyrë e myslimanëve që të ndryshojnë traditat e tyre që bazohen mbi shpërdorimin dhe duhet që cilësia e adhurimit t'i kthehet muajit të adhurimit, si dhe të mbizotërojnë kuptimet e xhihadit (sakrificës) dhe aftësisë për rezistencë përballë dëshirave dhe epsheve.

Shtëpia myslimane e kryen përgatitjen e ushqimit për familjen e saj dhe nuk është puna që ajo të hyjë në konkurrencë materiale të pavlerë për t'i ofruar më të shijshmen dhe më të shtrenjtën.

në konkurrencë materiale të pavlerë për t'i ofruar më të shijshmen dhe më të shtrenjtën. Kushtet ekonomike, në të cilat kalon ymeti ynë na imponojnë ngjyra kursimi dhe jo ngjyra lezetimi!

Shtëpia e caktuar vetëm për t'i dhënë tagji trupave, ajo nxjerrë shtazë! Ndërsa shtëpia, e cila ruan nderin, bindjen (adhurimin) dhe edukatën, prej saj dalin njerëz normalë.

Shtëpinë, të cilën e krijoi i zoti i Mesazhit të Madh, ajo është që ndryshoi pamjen e botës.

Ato shtëpi të ndriçuara ku janë ndaj shtëpive që kalojnë natën në programet televizive dëfryese boshe, pastaj shtrihen në shtrat sikur të jenë kufoma të palëvizshme, që nuk zgjohen, veçse për ngrënë sërish apo për të rend përtacish?!

Ramazani po vjen dhe së bashku me të vinë edhe shqetësimet e gostive të porositura, problemet e shumta për zgjidhjen e enigmave të papunësisë dhe sorollatjen nëpër bulevardet e qytetit që gumëzhijnë në mëkate!

Ymeti ynë vuan prej dështimeve shkencore, morale, industriale dhe tregtare. Kështu që, a do të zgjohemi prej mpirjes, e cila na ka ngurtësuar mendjen dhe gjymtyrët, e na ka hedhur pas karvanit të mbarë popujve të tjerë?!

(Nga libri: *Fi kadaja el-mer'eti bejne tekalidi er-rakide vel-vafide*)

Përktheu nga arabishtja
dhe përshtati në shqip:

Lavdrim Hamja



ZHVILLOHET KONFERENCA E 14-TË VJETORE E IMAMËVE: “RIMËKËMBJA E VETËDIJES ISLAME!”



Pasditën e të hënës, më 09 shkurt 2026, në xhaminë e Dy Vajzave, në prag të muajit të begatë të Ramazanit u zhvillua konferenca e 14-të vjetore e imamëve, teologëve dhe thirrësve islamë të Shkodrës, me temë: “Rimëkëmbja e vetëdijes islame!”

Konferenca u zhvillua në dy seanca ku imamë, teologë dhe thirrës islamë të Shkodrës, trajtuan tema të rëndësishme që lidhen me agjërimin e Ramazanit, rolin e tij në forcimin e besimit, vetëpërmbytjen, edukimin shpirtëror, si dhe ngjarje madhore historike islame.

Gjatë referimeve u sollën tefsire të ajeteve kuranore, reflektime mbi përjetimin e Ramazanit ndër breza, përfshirë edhe periudha të vështira të historisë sonë, si dhe trajtime shkencore e praktike mbi rregullat e agjërimit sipas medhhebit hanefi. Po ashtu, u theksua rëndësia e Natës së Kadrës, e betejës së Bedrit dhe mesazheve të mëdha që Ramazani i përcjell ymetit islam.

Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, në fjalën dhe kumtesën e tij apeloj që muaji i Ramazanit të shfrytëzohet si një mundësi reale për rikthim te Kur'ani, për forcimin e unitetit dhe për ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe më të ndërgjegjshme, duke e parë agjërimin si mjet transformimi individual dhe kolektiv.

Konferencën e përshëndeti edhe Myftiu i Malësisë së Madhe, H. Edmir Smajlaj.



Për këtë konferencë u paraqitën hoxhallarët e nderuar:

Imam Muhamed Sytari, Myfti i Zonës Shkodër: – Tefsiri i ajetit kur'anor: “Dhe, nëse agjëroni është më mirë për ju..!” – (El-Bekare: 184)

H. Adem Pizga, imam i xhamisë Perash: – Kuptimet e takvasë në agjërimin e Ramazanit

H. Arben Halluni, teolog: – Shembuj nga agjërimi i Ramazanit në periudhën e diktaturës komuniste në Shqipëri

H. Ardit Ulqinaku, imam i xhamisë Milan: – Tefsiri i ajetit kur'anor: “Nata e Kadrës, më e mirë se 1000 muaj!” – (El-Kadr: 3)

H. Ensar Ismailaj, imam i xhamisë Dërgut: – Agjërimi dhe vetëpërmbytja

H. Idmir Plaku, imam i xhamisë “Ebu Bekër”: – Tefsiri i ajetit kur'anor: “Ju është bërë obligim agjërimi...!” – (El-Bekare: 183)

H. Lavdrim Hamja, imam i xhamisë së “Dy Vajzave”: – Rregullat e agjërimit sipas medhhebit hanefi

H. Naim Drijaj, imam i xhamisë Parrucës: – Beteja e Bedrit – mësimet dhe mesazhe

H. Durim Kasemi, imam i xhamisë Parrucës: – Ramazani, muaji i ngjarjeve të mëdha.

Pas konferencës u bë edhe shpërndarja e materialeve të Ramazanit si kalendarë, postera, udhëzime, etj.



MYFTIU I SHKODRËS, MORI PJESË NË PRITJEN E AMBASADËS SË KUVAJTIT



Me ftesë të ambasadës së Shtetit të Kuvajtit në Tiranë, ditën e enjte, më 12 shkurt 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mori pjesë në ceremoninë e pritjes zyrtare të organizuar nga Ambasada e Kuvajtit në Tiranë, me rastin e 65 vjetorit të Pavarësisë dhe 35 vjetorit të Çlirimit të Kuvajtit, që përkohet me datat 25-26 shkurt.



Në fjalën e rastit, i Ngarkuari me Punë i Shtetit të Kuvajtit në Shqipëri, Z. Adnan Alghunaim, shprehu falënderimet për pjesëmarrësit në këtë ceremoni me rastin e dy festave kombëtare të Shtetit të Kuvajtit, ku ndër të tjera vuri theksin tek lidhjet e hershme të vëllazërisë dhe miqësisë ndërmjet Kuvajtit dhe Shqipërisë, sikurse u lut për mbarësi, prosperitet dhe mirëqenie të dy popujve.

Me rastin e kësaj pritjeje Myftiu i Shkodrës uroi të Ngarkuarin me Punë të Shtetit të Kuvajtit në Shqipëri, Z. Adnan Alghunaim, duke e falënderuar për kontributet e çmuara që Shteti i Kuvajtit ka dhënë për Shqipërinë, sidomos në tre dekadat e fundit, si një dëshmi e madhe e besimit, vëllazërisë dhe urave të forta që lidhin dy popujt tanë.

“RAMAZAN MUBAREK!” – ME URIMIN E PËRZEMËRT PËR MUAJIN E BEGATË, SHPËRNDAHEN MATERIALET E RAMAZANIT 1447/2026



Paraditen e së mërkurë, më 18 shkurt 2026, Myftinia Shkodër nën drejtimin e përgjegjës të sektorit të rinisë, H. Ervil Kuçi, organizoi aktivitetin: “Ramazan Mubarek!” duke shpërndarë për kalimtarët materiale të ndryshme për muajin e Ramazanit.

Aktiviteti u zhvillua pranë xhamisë së Parrucës, ku Myftinia Shkodër shpërndau kalendarin e agjërimit, gazetën “Udha Islame” dhe materiale të përshtatshme për muajin e Begatë për kalimtarët e ndryshëm, të cilët falënderuan këtë organizim dhe njëkohësisht ndanë

gëzimin e madh të muajit të Begatë të Ramazanit dhe urimet e tyre të përzemërta me organizatorët.

Myftinia Shkodër ju uron: Me zemër të mirë muajin e Begatë të Ramazanit. Agjërime të lehtë dhe të pranuar tek Allahu i Madhëruar!

MYFTIU I SHKODRËS MORI PJESË NË AKTIVITETIN E MYFTINISË ELBASAN NË PRAG TË RAMAZANIT

Me ftesë të Myftiut të Elbasanit, H. Agim Duka, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mori pjesë ditën e mërkurë, më 18 shkurt 2026, në aktivitetin në prag të hyrjes së muajit të Begatë të Ramazanit, që Myftinia Elbasan organizoi në teatrin Skampa.

I pranishëm në këtë aktivitet ishte edhe HT. H. Bujar Spahiu, Kryetar i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, si dhe imami dhe ligjëruesi i mirënjohur, H. Vladimir Kera.

Aktiviteti ishte një përzierje e mesazheve, këshillave dhe udhëzimeve të dobishme nga ligjëruesit e ftuar, si dhe programi i këndshëm i fëmijëve të shkollave dhe kurseve fetare të Elbasanit.

Në lajmin e shpërndarë nga Myftinia Elbasan në faqen e saj zyrtare ndër të tjera shkruhet:

“Ramazani, besim dhe përgjegjësi në shoqërinë bashkëkohore”, një aktivitet



i zhvilluar në ambientet e Teatrit “Skampa”, i cili mbledhi besimtarë, përfaqësues institucionesh dhe qytetarë të ndryshëm.

Fjalën përshëndetëse e përcolli Kryetari i Komunitetit Mysliman të Shqipërisë, H.H Bujar Spahiu, ndërsa mesazhin e tij për këtë muaj të bekuar e dha edhe Myftiu i Elbasanit, H. Agim Duka, duke theksuar rëndësinë e forcimit të besimit dhe solidaritetit në shoqërinë tonë.

Programi u pasurua me ilahi të interpretuara nga grupi i fëmijëve, të cilët me pastërtinë dhe sinqeritetin e tyre sollën një atmosferë të veçantë shpirtërore.

Një moment i rëndësishëm ishte ligjërimi i Myftiut të Shkodrës, H. Muhamed Sytari, me temën: “Ramazani dhe Kurani, rikthim te Fjala Hyjnore në një botë të shpërqendruar”, një refleksion i thellë mbi nevojën për t’u kthyer te vlerat hyjnore në një realitet gjithnjë e më sfidues.

Më pas, imami dhe teologu i njohur Vladimir Kera trajtoi temën: “Etika e Ramazanit në jetën familjare, publike dhe profesionale”, duke ndriçuar dimensionin praktik të Ramazanit si një shkollë edukimi moral dhe përgjegjësie në çdo aspekt të jetës sonë.

Programi u mbyll me paraqitjen e fëmijëve në skenë, duke lënë një mesazh shprese, vazhdimësie dhe përkushtimi ndaj vlerave të besimit.”



NË XHAMITË E SHKODRËS FALET TERA VIA E PARË, DUKE SHËNUAR FILLIMIN E MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT 1447/2026



Mbrëmjen e së mërkurë, më 18 shkurt 2026, në të gjitha xhamitë e Shkodrës u fal namazi i teravisë së parë i Ramazanit të këtij, duke shënuar në këtë mënyrë nisjen e muajit të Begatë të Ramazanit për mbarë ymetin islam.

Besimtarë të shumtë iu drejtuan shtëpive të Zotit me zemra plot besim, përkushtim dhe shpresë, për të përjetuar

nga afër atmosferën shpirtërore që sjell ky muaj i begatë.

Në shumë xhami të qytetit dhe të fshatit u regjistrua pjesëmarrje e madhe e besimtarëve frekuentues të xhamisë, ku ambientet u tejmbushën me besimtarë të të gjitha moshave. Një atmosferë e veçantë u përjetua edhe në xhaminë e Parrucës, ku në emër të Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni

mbajti një përshëndetje për besimtarët e pranishëm.

Në fjalën e tij, ai theksoi se Ramazani është muaj i mëshirës, faljes dhe afërimit me Allahun (xh.sh), duke i ftuar besimtarët që këtë stinë shpirtërore ta shfrytëzojnë për teube të sinqertë, përmirësim të vetes dhe forcim të lidhjeve familjare e shoqërore.



PARRUCË



MEDRESE



TRUSH



“DY VAJZAT”



Ishte një ngjarje e veçantë dhe e paharrueshme për mua si imam, për kryesinë dhe xhematin e kësaj xhamie. Ishte një natë që do të mbetet gjatë në kujtesën tonë, për nga atmosfera, organizimi dhe fryma e jashtëzakonshme e unitetit.

Programi u realizua në mënyrë të përkryer falë grupit të ilahistëve – një ndër më të mirët në vendet tona i udhëhequr nga Nusret Kurtishi, Almiri, Nafidani dhe Nderimi, të cilët me interpretimet e tyre prekën zemrat e të pranishmëve. Mbrëmjen e madhëruan edhe dy ligjëruesit e nderuar, dr. Bashkim Aliu dhe mr. Fehim Abazi, ndërsa moderimi u bë nga imami i xhamisë, Emin Odai, dhe mr. Bekim ef. Alimi, me ç'rast u krijua një ambient i mbushur me emocione qetësi shpirtërore dhe gëzim.

Ajo që përjetuam atë mbrëmje ishte vërtet e jashtëzakonshme. Çdo detaj ishte menduar me kujdes, por merita kryesore i takon xhematit tonë të dashur, i cili edhe një herë dëshmoi fuqinë e bashkimit, solidaritetit dhe përkushtimit ndaj shtëpisë së Allahut. Me mbështetjen e RTV Pendimit, nën drejtimin e Isak Sinanit dhe Lavdrim Munishit, gjatë kësaj

E XHUMA HISTORIKE PËR XHAMINË "EBU BEKËR ES-SIDDIK" NË BIEL/BIENNE TË ZVICRËS



mbrëmjeje u arrit të grumbullohet një shumë e konsiderueshme donacionesh.

Falënderimi ynë shkon edhe për xhamitë motra, për imamët për kryetarët dhe kryesitë e xhamiave dhe të gjithë ata që kontribuuan, qoftë me praninë e tyre apo përmes donacioneve online. Allahu i shpërbleftë të gjithë me të mirat e kësaj bote dhe të botës tjetër.

Si imam, kryesi dhe xhemat i Xhamisë Ebu Bekër Es-Siddik, shprehim mirënjohjen dhe urimet tona më të

sinqerta për suksesin e kësaj mbrëmjeje dhe lusim Allahun që kjo xhami të vazhdojë të jetë gjithmonë shembull i paqes, dashurisë, harmonisë dhe unitetit në komunitetin tonë.

Allahu ju shpërbleftë të gjithëve!

**Imami,
bashkë me udhëheqësinë
e xhamisë**

**(Me përshtatje nga profili zyrtar:
www.instagram.com/xhamiabiel)*

MYFTIU PRITI KRYETARIN E BASHKËSISË ISLAME SHQIPTARE NË DANIMARKË

Paraditën e së mërkurës, më 11 shkurt 2026, Myftiu i Zonës Shkodër, Imam Muhamed B. Sytari, priti në një takim të përzemërt e vëllazëror, Kryetarin e Bashkësisë Islame Shqiptare në Danimarkë, H. Basri Kurtishi.

Gjatë takimit, u diskutua rreth tematikave të ndryshme me interes të përbashkët, me theks tek studimet që lidhen me bashkëjetesën ndërfaqetare ndër shqiptarë, temë për të cilën, i nderuari H. Basri Kurtishi, është i specializuar, që nga ditët e studimeve në Universitetin e Ez'herit në Kajro, por edhe tani, në pozitën e Kryetarit të Bashkësisë Islame Shqiptare në Danimarkë.

Nga ana e tij, Myftiu i Shkodrës, tërhoqi vëmendjen drejt informacioneve të shumta në lidhje me temën, të botuara në revistat islame të para një shekulli në Shkodër e Shqipëri, tek të cilat u ndal me hollësi.

Pjesë e kësaj vizite ishte edhe ndalesa tek Xhamia e Plumbit, ku Kryetari i BISH në Danimarkë, pati mundësi të shihte nga afër detajet e kompleksit të ri, si dhe të mësonte për historinë e xhamisë, që i rezistoi përmbajtjeve dhe kohërave të



errëta, që asnjëherë s'e shuan Dritën e sinqeritetit, me të cilin u ngrit, si një kala Udhëzimi mbi tokë.

Në profilin e tij në fb, me rastin e kësaj vizite të shtrenjtë në Shkodër, H. Basri Kurtishi, shkruan: "Sot pata kënaqësinë të jem në vizitë në qytetin e Shkodrës, ku u takova me Muftiun e Shkodrës, Muhamed ef. Sytari. Shkodra, qyteti i kulturës, historisë dhe shpirtit të gjallë shqiptar.

Xhamia e Plumbit që është një xhami që ka përballuar shumë etapa e sfida të historisë sonë. Ajo qëndron pranë



Kalasë se Rozafës, por rezistenca e saj shpirtërore duket edhe më e fortë se muret e kalasë.

Kjo xhami nuk është thjesht një objekt kulturi. Ajo simbolizon rrënjët e thella të fesë në shoqërinë tonë. Edhe pse kemi kaluar vështirësi, ndalime e përndjekje, besimi ka mbetur pjesë e pandashme e identitetit tonë.

Shkodra të kujton se historia jonë ka pasur plagë, por edhe forcë për t'u ringritur. Dhe Xhamia e Plumbit qëndron aty si dëshmi e qëndrueshmërisë, besimit dhe shpirtit Shqiptar."

Në vazhden e aktiviteteve të larmishme, që Myftinia Shkodër po zhvillon në atmosferën e begatë të Tre Muajve të Mirë, ditën e shtunë, më 7 shkurt 2026, në xhaminë e Parrucës, u zhvillua tribuna fetare me të ftuar nderi, ligjëruesin e nderuar nga Tirana, H. Gentjan Mara.

Pas hapjes së programit nga teologu Arben Halluni, një fjalë përshëndetëse mbajti Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili përshëndeti të pranishmit dhe uroi mirëseardhjen mysafirrit nga Tirana, hoxhë Gentjan Mara, hatib i xhamisë Xhura, duke vlerësuar kontributin e tij në shërbim të fesë dhe komunitetit.

Më pas, fjalën e mori imami i nderuar, H. Gentjan Mara, i cili u ndal gjerësisht në vlerat dhe rëndësinë e muajit të shenjtë të Ramazanit. Në ligjëratën e



Në vazhden e ciklit të ligjëratave në prag të muajit të madhërisëm të Ramazanit, ditën e mërkurë, më 11 shkurt 2026, Myftinia Shkodër zhvilloi një tribunë fetare në Qendrën Kulturore pranë xhamisë së fshatit Mes-Myselim, Njësia Administrative Postribë.

Aktiviteti që nisi me faljen e namazit të iqindisë vijoi me fjalën e rastit të mbajtur nga teologu Arben Halluni, i cili vuri theksin tek rëndësia e aktiviteteve të larmishme që zhvillohen me qëllim ndërgjegjësimin e besimtarëve në prag të muajit të begatë të Ramazanit.

Më pas, të pranishmëve iu drejtua Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, i cili vuri theksin tek rëndësia që



"AGJËRIMI, RRUGA E NJERËZVE TË DEVOTSHËM", KËSHILLA DHE MESAZHE NGA H. GENTJAN MARA



tij, ai trajtoi aspekte të ndryshme të këtij muaji të bekuar, si dimensionin shpirtëror, shoqëror, moral, familjar dhe praktik, duke sjellë shembuj konkretë

nga jeta e Pejgamberit Muhammed (a.s), sahabëve dhe brezave të parë të mirë.

Ajo që u vlerësua nga pjesëmarrësit, ishte larmia e shembujve nga trashëgimia islame ndër shekuj, si dhe nga përvojat personale të hoxhës së nderuar, që tërhoqën vëmendjen e besimtarëve pjesëmarrës në këtë aktivitet me vlerë.

Tribuna u ndoq me interes nga besimtarët e pranishëm, të cilët e vlerësuan këtë aktivitet si një mundësi e çmuar për reflektim, këshillë e vyer dhe forcim i lidhjes me vlerat islame në prag të Ramazanit.

"TË NDRIÇOHEMI, PO NA VJEN MUAJI I KUR'ANIT!", MESAZHE DHE KËSHILLA NGA MYFTIU I SHKODRËS



hutimi dhe përgatitjen serioze për të pritur siç duhet muajit e madhërisëm të mrekullive të panurmëta.

Myftiu iu drejtua të pranishmëve me mesazhe të shumta nga Kur'an, hadithe e Pejgamberit (a.s) dhe mesazhet e sabahëve të ndryshëm, që duke tërhequr vëmendjen drejt domosdoshmërisë së parapërgatitjes me rastin e muajit të agjërit, duke e konsideruar atë si një mundësi e jashtëzakonshme që Zoti i gjithësisë ia mundëson besimtarëve të Tij dhe njerëzimit mbarë për t'u kthyer nga drita e udhëzimit dhe të kapurit me seriozitet pas litarit të Allahut, Kur'anit Famëllartë.

Aktiviteti u përshëndet edhe nga teologu i nderuar Fatmir Sula, i cili falënderoi pjesëmarrësit dhe vlerësoi punën e madhe të besimtarëve të xhamisë së Mes-Myselimit për ta dëshmuar mirësinë e besimit dhe vlerat e tij, me vepra të dobishme e aktivitete që mbajnë gjallë frymën e identitetit islam në komunitet.

NGA VJENA, MYFTIU I SHKODRËS URON BESIMTARËT NË PRAG TË MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT

Me ftesë të Bashkësisë Islame Shqiptare për Integrim, Xhamia Shqiptare në Vjenë "El-Kalem", Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, po zhvillon një vizitë dy ditore në Vjenë.

Ditën e xhuma, më 13 shkurt 2026, Myftiu mbajti hytben e xhumasë nëpërmjet të cilës iu drejtua besimtarëve të shumtë nga të gjitha trojet shqiptare që frekuentojnë këtë xhami, në prag të muajit të begatë të Ramazanit.

Gjatë mesazhit të tij, Myftiu vuri theksin tek mirësia e madhe me të cilën Zoti i gjithësisë begaton mbarë njerëzimin dhe besimtarët në veçanti teksa i fton të angazhohen për një muaj me radhë në agjërimin e muajit të begatë të Ramazanit.

Myftiu theksoi se atmosfera e begatë e Ramazanit e merr përdore besimtarin dhe individin musliman që të paqtohet me Zotin e tij dhe me tjetrin kushdo qoftë ai, duke rrezatuar mësimet themelore të periudhës së begatë të agjërit, që janë



vetëkontrolli, distancomi nga haramet dhe ndalesat e shumta, rrezatimi i të mirës në marrëdhënie dhe komunikimi me familjen, shoqërinë, solidarizimin me njerëzit në nevojë, përhapja e ndihmës së pakushtëzuar, distancimi nga thashethemaja, fjalët e pavlefshme, veprat e padobishme dhe angazhimi maksimal për të qenë njeri prodhimtar në përditshmërinë e tij.

Myftiu Sytari uroi muslimanët e krejt trevave shqiptare dhe të mbarë botës islame në prag të muajit të

begatë të Ramazanit, duke u lutur që Zoti i gjithësisë të derdhë mëshirë dhe begati për të gjithë shqiptarët kudo që janë dhe për mbarë njerëzimin, që ka nevojë sot më shumë se asnjëherë për balsamin e udhëzimit hyjnor dhe kthimin me sinqeritet dhe seriozitet nga dera e udhëzimit hyjnor.

Myftiu falënderoi kryetarin e xhamisë "El-Kalem", z. Artan Istrefi dhe imamin e saj, H. Samel Haxhija për ftesën bujare dhe mikpritjen e ngrohtë e vëllazërore.

MYFTINIA SHKODËR PRANË FAMILJEVE NË NEVOJË NË PRAG TË MUAJIT TË BEGATË TË RAMAZANIT 1447/2026

Në atmosferën e begatë të muajit të madhërisë të Ramazanit, ku shtohen bamirësitë dhe solidarizimi me njerëzit në nevojë, skamnorët, jetimët, por jo vetëm, Myftinia Shkodër nisi shpërndarjen e pakove të bereqetit të Ramazanit.

Përfaqësuesi i Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, para mediave shprehu mirënjohjen për të gjithë kontribuuesit dhe bamirësit, që u bënë pjesë e kësaj nisme humanitare, duke theksuar se gjatë gjithë muajit të Ramazanit do ketë të tjera veprimtari ndihmese për të lehtësuar barrën e familjeve në nevojë dhe shtresave të ndryshme skamnore.



Kjo fushatë është pjesë e projektit Shporta e Ushqimit nga "Qendra e Mbretit Salman për Ndihmë dhe Punë Humanitare", që Komuniteti Mysliman i Shqipërisë zhvillon në bashkëpunim me Ambasadën e Arabisë Saudite në Tiranë.

Ky aktivitet humanitar vjen si pjesë e angazhimit të vazhdueshëm të Myftinisë Shkodër për të qenë pranë shtresave më të ndjeshme të shoqërisë, duke përçar mesazhin e solidaritetit, mëshirës dhe kujdesit për njëri-tjetrin, vlera që Ramazani i forcon edhe më shumë në zemrat e njerëzve.



MYFTIU PRITI KRYETARIN E BASHKISË SHKODËR NË PRAG TË MUAJIT RAMAZAN 1447/2026



Paraditen e së mërkurës, më 18 shkurt 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari priti në një takim pune Kryetarin e Bashkisë Shkodër, z. Benet Beci.

Gjatë takimit u diskutua për një sërë çështjesh me interes të përbashkët, ku u vu theksi tek atmosfera e muajit të Begatë të Ramazanit dhe domosdoshmëria e bashkëpunimit për ruajtjen e atmosferës së begatë të këtij muaji të shenjtë për muslimanët e mbarë botës dhe të Shkodrës në veçanti.



Pjesë e këtij takimi ishte edhe inspektimi i punimeve në sheshin e vakëfit të Parrucës, ku Myftiu në shoqërinë e Kryetarit të Bashkisë ndoqën punimet që po kryhen për veshjen e xhamisë së Parrucës dhe sistemin e oborrit të saj.

Kryetari i Bashkisë Shkodër, z. Benet Beci uroi Myftiun e Shkodrës dhe nëpërmjet tij krejt besimtarët muslimanë të Shkodrës me rastin e muajit të Begatë të Ramazanit, duke u lutur për një muaj plot e bekime dhe mirësi, si dhe duke shprehur gatishmërinë e institucionit të Bashkisë së Shkodrës për çdo bashkëpunim të dobishëm në interes të komunitetit.

XHAMIA BARDHAJ, AKTIVITET MË FËMIJËT NË PRAG TË MUAJIT TË MADHËRUAR TË RAMAZANIT



Me rastin e ardhjes së muajit të madhërueshëm të Ramazanit, nxënësit e Qendrës Kulturore, pranë xhamisë Bardhaj, nën drejtimin e hoxhës së nderuar, Ilir Dizdari dhe bashkëshortes së tij znj. Aurelda Dizdari, zhvilluan një aktivitet të veçantë fetaro-edukativ.

Në një atmosferë të mbushur me emocion dhe përkushtim, nxënësit

përcollën mesazhe të bukura përmes recitimeve, ilahive dhe fjalëve kushtuar vlerave të muajit të Begatë të Ramazanit.

Programi u karakterizua nga thjeshtësia dhe sinqeriteti i fëmijëve, të cilët me zërat e tyre të pastër sollën mesazhe dashurie, paqeje, respekti dhe mirësie.

Ky aktivitet u organizua nën kujdesin e sektorit të arsimit pranë Myftinisë Shkodër.



SOFRA E IFTARIT TË VËLLAZËRISË ME NXËNËSIT E MEJTEPIT DHE QENDRËS KULTURORE TË XHAMISË BARDHAJ



Ditën e martë, më 24 shkurt 2026, në ditën e 6-të të muajit të Begatë të Ramazanit, sektori i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, organizoi veprimtarinë e iftarit me nxënësit e xhamisë Bardhaj, Njësia Administrative Rrethina.

Në këtë iftar, përveç pjesëmarrjes së rreth 45 nxënësve të moshave të ndryshme, imamit dhe mësuesit të përkushtuar, H. Ilir Dizdari, mori pjesë edhe drejtuesi i arsimit, pranë Myftinisë Shkodër, teologu Arben Halluni, i cili përpara çeljes së iftarit, dha disa këshilla të dobishme edukative dhe besimore për

të pranishmit.

Duke i uruar nxënësve për një agjërimit të lehtë dhe një Ramazan të pranuar, teologu Halluni shprehu urimet e tij të përzemërta për këtë Muaj me plot mirësi dhe devotshmëri.

Në fund të iftarit, u bë dua e sofrës si dhe më pas u kry falja e namazit të akshamit me xhematë.

Programi i sofrës së iftareve të vëllazërisë me mejtepet dhe qendrat islame të Myftinisë Shkodër do të vazhdojë përgjatë këtij Muaji të Begatë të Ramazanit.



BEREQETI I MUAJIT TË RAMAZANIT GËZON 250 FAMILJE



Ditën e xhuma, më 20 shkurt 2026, Myftinia Shkodër përmes bashkëpunimit me Fondacionin "Mirësia" dhuruan për 250 familje pako ushqimore, me rastin e muajit të Begatë të Ramazanit.

Ky kontingjent ndihmash vjen falë mbështetjes dhe bashkëpunimit, që Fondacioni "Mirësia" ka me Shoqatën IHH në Turqi, të cila kishin zgjedhur Shkodrën për të realizuar këtë projekt bamirës me rastin e fillimi të muajit të Begatë të Ramazanit.



Fillimisht, në xhaminë e Kirasit, u shpërndanë 200 pako ushqimore për familjet me jetimë dhe pastaj 50 pako të tjera u shpërndanë pranë Qendrës Kulturore Oblikë.

Myftinia Shkodër falënderon donatorët bamirës dhe shpreh mirënjohje të veçantë për Fondacionin "Mirësia" dhe Shoqatën IHH në Turqi.

"JU ËSHTË BËRË OBLIGIM...!", MYFTIU I SHKODRËS I FTUAR NË PEACE TV

Nëpërmjet kanalit të mirënjohur, Peace Tv, besimtarët patën mundësi të ndiqnin, mbrëmjen e së xhumasë, më 20 shkurt 2026, bashkëbisedimin që hojha i nderuar nga Mitrovica, H. Muhamed Dërmaku, zhvilloi me Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.



Një bashkëbisedim i mbushur me detaje të shumta, që lidhen me jetën dhe aktivitetin e Myftiut, me Shkodrën dhe xhamitë e saj, Medresenë dhe veprimtaritë e saj, gjurmët e hoxhallarëve të shkuar, rezistencën në komunizëm, dijetarët shkodranë në Damask të Sirisë dhe kujtimet e paharruara para duarve të tyre.

Gjatë këtij emisioni me vlerë, Myftiu Sytari hodhi dritë edhe rreth kuptimeve të pjesës së ajetit të agjërimit: "Ju është bërë obligim...!", ku theksoi se agjërimi i Ramazanit është shenjë e padiskutueshme e dashnisë së Allahut për robin e Tij, një amanet i shenjtë, që është vendosur në duart e besimtarëve, për kryerjen e të cilit, shpërblimet janë të pallogaritura.

Në fund të këtij bashkëbisedimi plot vlerë, Myftiu i Shkodrës kishte një porosi edhe për rininë, prej të cilëve kërkoi që të rrijnë pranë gjyshërve dhe të kërkojnë prej tyre që për çdo natë Ramazani, t'ju tregojnë nga një kujtim nga agjërimi i tyre ndër vite, në mënyrë që lidhja e brezëve në agjërimit të kthehet në një besëlidhje të shenjtë që trashëgohet me shumë dashni, brez pas brezi ndër ne.

(Për të gjithë ata që nuk kanë pasur mundësi ta ndjekin drejtpërsëdrejti këtë emision, më poshtë linku i tij!)

MYFTIU: "RAMAZANI, MUNDËSI E MADHE E VETËPËRMIRËSIMIT!"



Ditën e mërkurë, më 25 shkurt 2026, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari, mbajti ligjëratën e radhës në prag të namazit të teravisë në xhaminë e lagjes Dërgut.

Në praninë e të rinjve të shumtë që frekuentojnë këtë xhami, Myftiu dha disa mesazhe me rëndësi në funksion të vetëpërmirësimit dhe shfrytëzimit të ditëve dhe netëve të muajit të Begatë të Ramazanit për të bërë gjithësecili llogaritë e tij me Zotin e gjithësisë në funksion të distancimit dhe largimit nga gjynahet dhe veprat e papëlqyera në Islam dhe lartësimit në gradat më të larta të shembullit të njerëzve të përkushtuar.

Në këtë kontekst, Myftiu solli në vëmendje të besimtarëve të pranishëm një ngjarje nga aktualiteti që ka të bëjë me rëndësinë e vlerësimit të pozitës së

nënës në jetë, ku tërhoqi vëmendjen e të gjithëve drejt një fjale të madhe sahabiut Ebu Derda (r.a) që thotë: "Vepra e mirë nuk tretet, gjynahu regjistrohët, i Plotfuqishmi nuk vdes, atë që bën, do ta bëjnë!"

Myftiu tërhoqi vëmendjen drejt domosdoshmërisë së shfrytëzimit të periudhës së begatë Ramazanit për t'u penduar, për të kërkuar falje përpara duarve të Allahut, për t'i kërkuar hallallëk njëri-tjetrit dhe për ta pastruar realitetin e përditshmërisë tonë nga njollat e gjynaheve dhe gjurmët e hirta të tyre në përditshmërinë tonë.

Muaji i Ramazanit është një periudhë e begatë, ku Myftiu dhe imamët e ndryshëm të xhamive tona japin çdo natë mesazhe dhe këshilla të dobishme për besimtarët në frymën e përjetimeve të larta shpirtërore përgjatë kësaj periudhe të begatë.



MYFTIU I SHKODRËS: “LUTJA, BAROMETËR I MARRËDHËNIES REALE ME ZOTIN, NJË!”



Me ftesë të xhamisë “Bashkimi”, në Linz të Austrisë, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari mbajti ditën e xhuma, më 27 shkurt 2026, hytben e xhumasë përpara numrit të madh të besimtarëve muslimanë shqiptarë që frekuentojnë këtë xhami të shquar për aktivitetin e saj në Austri.

Në mesazhin me të cilin iu drejtua besimtarëve të pranishëm, Myftiu i Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari u përqendrua tek mirësia e madhe me të cilën është rrethuar ymeti islam gjatë këtyre ditëve të bekuara të muajit Ramazan.

Myftiu theksoi se fakti që të gjithë ne e kemi mbërritur këtë muaj të bekuar dhe po përjetojmë mirësitë dhe mëshirën e Allahut në përditshmërinë e këtyre ditëve, është në dëshmi e madhe e dashnisë së Allahut për gjithësecilin prej nesh. Myftiu vuri theksin tek rëndësia e madhe që ka lutja si thelbi i adhurimit të agjërit, ndryshe si barometër i vërtetë që përcakton marrëdhënien reale të muslimanit me Zotin e gjithësisë, Allahun e Madhëruar.

Ndër të tjera Myftiu theksoi: “Të dashur dhe të shtrenjtë vëllezër besimtarë, është fatmirësi e madhe që Krijuesi i gjithësisë e ka lënë të hapur derën e lutjes për gjithësecilin prej robërve të Tij, duke i ftuar nëpërmjet një ajetei madhështor, ku i drejtohet Pejgamberit (a.s) duke i thënë: ‘Nëse të pyesin robërit e Mi për Mua, Unë jam afër, i përgjigjem lutjes së lutësit!’ – (Kur’ani, El-Bekare: 186)

Ky ajat i mrekullueshëm i dëshmon besimtarit se Allahu Mëshirëplotë është përherë ‘afër’, po muslimani sa afër Zotit të tij është në përditshmërinë e tij?

Nëpërmjet shembujve të shumtë dhe

argumenteve të bollshme Zoti i gjithësisë na tregon për shembullin e më të mirëve të racës njerëzore, Pejgamberëve të Tij, ku një shumësi prej tyre janë përjetësuar në Kur’nin Famëlartë nëpërmjet lutjeve të ndryshme e të larmishme me të cilat i drejtoheshin Krijuesit të gjithësisë në momente të ndryshme të jetës së tyre

Imagjinoni për pak Pejgamberë të shquar nga Hz. Ademi (a.s), Hz. Nuhu (a.s), Hz. Junusi (a.s), Hz. Ibrahim (a.s), Hz. Zekerija (a.s), Hz. Sulejmani (a.s), Hz. Musa (a.s), etj, lutjet e të cilëve janë regjistruar në Kur’anin Famëlartë.

Sa e sa lutje të përditshme që na janë mësuar nëpërmjet traditës të Pejgamberit tonë (a.s), si e si për të na marrë për dore që mos ta neglizhojmë këtë bekim të madh të Allahut në jetën tonë të përditshme

A ka justifikim muslimani i sotëm që ankohet për probleme të ndryshme në jetën e tij, për shqetësime për halle, për telashe, për ngërçe, për ngushtimi e rizikut, për problematika të ndryshme në familjen e tij, në shoqërinë e tij, që të ngelet në batakun e vështirësive të tij, ndërkohë që dera e lutjes është e hapur.

Prandaj, të nderuar dhe të shtrenjtë vëllezër besimtarë, le ta shfrytëzojmë këtë kohë të bekuar të muajit të Ramazanit për të përsosur marrëdhënien që kemi me Zotin e gjithësisë nëpërmjet asaj që ka kërkuar dhe legjitimuar për ne; lutjes!”

Gjatë qëndrimit në Linz, Myftiu do të marrë pjesë edhe në disa aktivitete të tjera që zhvillon xhamia “Bashkimi”, përfshirë iftarin e madh me rininë dhe besimtarët, tribunën fetare para namazit të teravisë, si dhe bashkëbisedimin e hapur me një grup të rinjsh dhe aktivistësh të saj.



Pejgamberi (a.s) ka thënë:

“*Në xhenet është një derë, e cila quhet “Rejjan”, përmes saj hyjnë agjëruesit në Ditën e Kiametit. Askush tjetër nuk hyn prej saj, përveç tyre. Thuhet: Ku janë agjëruesit? Ata ngrihen në këmbë, hyjnë nga ajo derë, pastaj ajo mbyllet.*”

(Transmeton Buhariu)

MYFTIU I SHKODRËS MORI PJESË NË TRIBUNËN FETARE TË XHAMISË “BASHKIMI” NË LINZ TË AUSTRISË

Ditën e shtunë, më 28 shkurt 2026, pas namazit të akshamit, xhamia “Bashkimi” në Linz të Austrisë organizoi një tribunë fetare me të ftuar nderi, Myftiun e Shkodrës, Imam Muhamed B. Sytari.

Në fjalën e rastit, imami i kësaj xhamie, hoxha i nderuar, H. Menderez Alili shprehu kënaqësinë e tij personale dhe të kryesisë së xhamisë “Bashkimi” për praninë e Myftiut të Shkodrës në mesin e tyre në këtë natë të begatë të Ramazanit.

Ai theksoi se muaji Ramazan është një periudhë e bekuar kohore, me të cilën aktiviteti fetar gjallërohet më shumë se në çdo pjesë tjetër të vitit.

Njëkohësisht falënderoi Myftiun e Shkodrës për pranimin e ftesës dhe i uroi atij mbarësi dhe suksese në aktivitetin e gjerë në shërbim të Thirrjes Islame.

Në ligjëratën e tij të kësaj mbrëmjeje të shënuar në xhaminë “Bashkimi”, Myftiu i Shkodrës u ndal tek rëndësia që ka përkushtimi në jetën e përditshme të muslimanit për të dëshmuar Islamit nëpërmjet veprave konkrete, duke përsosur punën e përditshme dhe duke dëshiruar për tjetrin atë që dëshiron për vete.

Myftiu Sytari iu qas hadithit të Pejgamberit (a.s) që thotë: “Besimtari është njeri i dashur dhe që duhet edhe nga të tjerët, dhe nuk ka dobi në një person, i cili nuk do të tjerët dhe të tjerët nuk e duan!”

Nëpërmjet kësaj Myftiu kërkoi nga besimtarët e pranishëm, sidomos rinia e shumë, ta shfrytëzojnë kohën për



ta përsosur marrëdhënien e tyre me besimin dhe fenë dhe për t’u veshur me moralin për ta dëshmuar atë në përditshmërinë e tyre në marrëdhënie me njerëzit kushdo qofshin ata.

Më pas Myftiu Sytari solli në vëmendje të pranishmëve ajetin 208 të sures El-Bekare: “O ju që besuat, hyni tërësisht në Islam (nënshtrohuni plotësisht), e mos ndiqni rrugën e djallit, sepse ai është armik i juaj i hapët!”, ku theksoi se ftesa hyjnore për ta praktikuar Islamit në tërësi është ftesë për të ruajtur dinjitetin dhe për të ndjerë krenarinë e përkatësisë dhe lidhjes me fenë e Allahut të Madhëruar.

Ndër të tjera, ai theksoi se në të gjitha shtyllat islame adhurimet kanë një emërues të përbashkët që është ruajtja e ekuilibrit të fesë në jetën e përditshme, nxitja e përkushtimit dhe dorëzimi para vullnetit të Allahut dhe të jetuarit me dinjitetin e mëkëmbësit

të Zotit në tokë.

Në përfundim të ligjëratës së Myftiut, kryetari i xhamisë “Bashkimi” në Linz, z. Zumret Ademi, i dorëzoi Myftiut të Shkodrës pllakatën e Mirënjohjes së xhamisë “Bashkimi” për kontributin dhe pjesëmarrjen në këtë tribunë të paharruar.

I pranishëm në këtë tribunë fetare, ishte edhe kryetari i Komunitetit Shqiptar të Bashkësisë Islame të Austrisë (ALKIG), H. Vahidin Beluli, i cili iu drejtua të pranishmëve me një urim dhe përshëndetje të posaçme në këtë organizim me rastin e muajit të Begatë të Ramazanit.

Pas tribunës fetare u fal namazi i jacisë i pasuar nga 20 rekatet e teravisë dhe më pas u zhvillua një mexhlis i begatë me pyetje-përgjigje që e gjallëroi këtë natë të begatë dhe të paharruar.



RAMAZAN 1447|2026



ZEKATI

2.5%



ZEKATI, SADAKATUL-FITRI DHE FIDJA

- **Sadakatul-Fitri** është **400 lekë** (të reja) për çdo person.
- **Fidja** (kompensimi) për të sëmurët, është **400 lekë** (të reja) për çdo ditë të Ramazanit.
(Sadakatul-Fitri dhe Fidja duhet të jepen përpara Bajramit)
- **Zekati** (Nisabi - niveli minimal i detyrimit të zekatit) është **840.000 lekë** (të reja).

Pagesat mund t'i bëjnë pranë zyrës së Myftinisë Shkodër, ose përmes bankës: United Bank of Albania – Myftinia Shkodër



LEKË

IBAN LEK: **AL11-2035-1102-2010-1521-1100-0546**



EURO

IBAN EUR: **AL61-2031-0025-1702-0015-0000-0210** | SWIFT: **AAISALTR**



DOLLAR

IBAN USD: **AL50-2035-1102-2010-1401-1100-0543**



myftiniashkoder1990



www.myftinia-shkoder.org



Parrucë, Shkodër

Botues:
Myftinia Shkodër
Drejtues:
Imam Muhamed Sytari

Kryeredaktor:
Lavdrim Hamja

Tel / Fax:
+355 (0) 224 2081
Nr. llogarie:
100054 UBA - Shkodër



MYFTINIASHKODER1990
udhaislame@myftinia-shkoder.org
www.myftinia-shkoder.org